

Tirana FLET!

Strukturat komunitare në Shqipëri



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Tirana FLET!

Strukturat komunitare në Shqipëri

MANUAL

Maj 2016

Përmbajtja

Në vend të hyrjes ...	3
Strukturat komunitare në ligjin e ri “Për Vetë Qeverisjen Vendore”	10
Misioni i strukturave komunitare	12
Karakteristikat dhe detyrat e strukturave komunitare efektive	14
Marrëdhëniet e strukturave komunitare me institucionet	18
Pesë dimensionet e fuqizimit të komunitetit	20
A mund të jesh anëtar i këshillit komunitar?	22
Sfidat e strukturave komunitare në kontekstin shqiptar	24
Shembuj të angazhimit qytetar në zhvillimin lokal	33
Fjalorth	38
Burime informacioni	41

STRUKTURAT

KOMUNITETI

- Strukturat komunitare janë të lidhura ngushtësisht me një minizonë të caktuar urbane;
- Këshilli komunitar zgjidhet me pëlqimin e banorëve të këtij territori;
- Ndërlidhësi është një nga anëtarët e këshillit komunitar;
- Këshilli Bashkiak rregullon veprimtarinë e strukturave komunitare.



BASH
TIRA



STRUKTURAT KOMUNITARE



KOMUNITARE



- Strukturat përfaqësojnë popullsinë e një minizone urbane në tërësinë e tij, (të rinjtë, gratë, të moshuarit, të punësuarit apo të papunët e të tjera).
- Pjesë e strukturës komunitare mund të jetë kushdo që dëshiron dhe mendon se mund të kontribuojë për një jetë më të mirë në komunitet.
- Objektivi më i lartë i kësaj qasje është të lidhë ndjenjat dhe përgjegjshmërinë qytetare me komunitetin e minizonës.



ndërlidhësi



- Strukturat komunitare jetësojnë ndëreveprimin qytetar në zonë;
- Strukturat komunitare marrin përgjegjësi nga Këshilli dhe Kryetari i Bashkisë;
- Strukturat komunitare janë urë lidhëse dhe instrument partneriteti midis komunitetit dhe institucioneve publike.

Ky manual synon të prezantojë një alternativë qeverisëse ndryshe, të ndajë gjerësisht një vizion, por edhe të motivojë nismën e institucioneve vendore dhe qendrore drejt kërimit dhe vendosjes së një partneriteti me qytetarin si subjekt i rëndësishëm i ndryshimit. Përmirësimi i qeverisjes dhe cilësisë së jetës nuk mund të jetë e drejtë ekskluzive e shtetit dhe qeverisë.


Manuali i vjen në ndihmë dhe pritjet të pranohet nga të gjithë aktorët e mundshëm si partnerë të domosdoshëm të këtij ndryshimi. Ai mbështetet në rolin e rëndësishëm të institucioneve. Gjithsesi, dhe mbi të gjitha, manuali është për qytetarin, sepse ndryshimi mund të vijë vetëm prej tij, prej qytetarëve të fuqizuar.

Nisma dhe synimet e cituara vijnë në mbështetje të detyrimeve të Ligjit të ri “Për Vetëqeverisjen Vendore” (nenet 68 dhe 69) që kërkojnë krijimin e një realiteti të ri të organizimeve komunitare. Ky realitet përbën ndoshta një moment historik në zhvillimin e demokracisë, sepse përafron një dinamikë publike që fuqizon qytetarët për rolin e tyre në qeverisje.

Kjo nismë kërkon krijimin e një mjedisi mundësues për ngritjen e këshillave komunitare me nismën dhe vullnetin e qytetarëve në çdo minizonë urbane. Në këtë aspekt, manuali do të trajtojë në rubrika të veçanta më konkretisht qasjen ndaj krijimit të strukturave komunitare dhe rolin e qytetarëve për t'i dhënë jetë organizimit komunitar si përgjegjësi qytetare. Nga ana tjetër, manuali do të qartësojë edhe çështje që kanë të bëjnë me procesin rregullator normativ që pritjet të realizohet nga qeverisja vendore.

Procesi i ngritjes së strukturave komunitare përbën një risi për realitetin shqiptar dhe si i tillë ai është mbi të gjitha edukativ për qytetarët dhe institucionet. Nisma kërkon një kulturë qeverisëse ndryshe që shkon drejt





qytetarit, njëherazi edhe ndryshim të mentalitetit menaxherial mbështetur në një rol aktiv të qytetarit dhe grupeve komunitare. Veçmas, nisma kërkon pikësëpari një qytetari aktive dhe gadishmëri për kontribute nga poshtë të shoqërisë dhe për këtë shembujt janë në rritje se qytetarët po marrin një rol gjithmonë e më tepër në menaxhimin e jetës publike.

Siç shihet, sfidat janë të mëdha dhe jo fort të lehta. Mbi të gjitha, sepse kërkohet ndërhyrje në raportet ndërpersonale mes njerëzve në komunitetet vendore. Investimi përforcimin e kapitalit social është dimension i munguar në politikat publike gjatë gjithë periudhës së tranzicionit të vendit. Në disa analiza dhe diskutime publike shumë nga arsyet për mosecjen e gjërave në drejtimin e duhur i atribuohen pasivitetit shoqëror e qytetar dhe mungesës së një perspektive për zhvillimin nga poshtë të shoqërisë, apo qeverisjes “me një drejtim”, pra nga qeveria tek qytetari dhe jo edhe nga poshtë-lart.

Edhe më kërkuese bëhet situata me njësitë e reja të qeverisjes vendore, ku përfshihen territore më të gjera urbane dhe rurale dhe ku përfaqësimi dhe pjesëmarrja e komuniteteve vendore në qeverisje dhe vendimmarrje është edhe më sfiduese. Ligji i ri “Për Vetëqeverisjen Vendore” e ka paraparë përballjen me këtë problematikë. Bashkia e ushtron administrimin e tij në periferi përmes njësive administrative. Ndërkohë, për herë të parë në legjislacionin kombëtar parashihet nisma e qytetarëve për t’u vetëorganizuar e kontribuar në forma e mënyra të ndryshme për aktivizim dhe pjesëmarrje në përmirësimin e qeverisjes dhe cilësisë së jetës në komunitetin vendor.

Në këtë rast, me nismë të Bashkisë së Tiranës dhe në partneritet me shumë aktorë të tjerë të shoqërisë civile, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) po investon gjithë përvojën e saj shumëvjeçare për të institucionalizuar një mënyrë qeverisjeje përmes pjesëmarrjes së qytetarëve. Ne jemi të vetëdijshëm se kjo nuk është një sipërmarrje e lehtë. Stepja e parë që lind në këtë parashtrim lidhet me një skepticizëm dhe mungesën e besimit se ky ndryshim mund të ndodhë dhe se komunitetet qytetare mund të marrin përgjegjësi qeverisëse. Jo aq i lehtë është edhe ndryshimi i mentalitetit të drejtimit apo menaxhimit të jetës publike duke vlerësuar qytetarin partner në qeverisje.



Në tërësinë e tij, mjedisi social por edhe institucional në vend, deri më sot, nuk ka qenë i udhëhequr nga filozofi dhe modele qeverisëse që ftojnë dhe mbështeten në ndërveprimin nga lart-poshtë e anasjelltas. Por, ndryshimi i synuar duhet të ndodhë. Pikësëpari, sepse nuk ka një alternativë tjetër (veçse fuqizimit të qytetarëve) për të zëvendësuar boshllëkun dhe distancën e qytetarit me qeverisjen për sa i përket përfaqësimit, pjesëmarrjes, aktivizimit, qytetarisë, civilizimit, përgjegjësisë, llogaridhënies, humanizmit, vullnetarizmit, e të tjera. Kjo është njëra anë, njëherazi mjaft e rëndësishme, sepse i bën qytetarët të ndjehen subjekt të ndryshimit.

Ana tjetër është se vetë institucionet kanë nevojë jetike për bashkëpunimin dhe ndërveprimin me strukturat komunitare, të cilat realisht janë zgjedhur nga komunitetet vendore. Është e vështirë të përfytyrohet një qeverisje demokratike, zbatim efikas i ligjit në nivel vendor nga çdo institucion publik, politika ekonomike për zhvillim të qëndrueshëm në mënyrë të veçantë në zonat rurale, përfshirje sociale dhe ulje të pabarazisë shoqërore pa pjesëmarrjen dhe kontributin e qytetarëve dhe komuniteteve vendore në proceset qeverisëse. Përpjekjet për të minimizuar korrupsionin dhe përmirësuar llogaridhënien publike mund të jenë më të suksesshme përmes forcimit të zërit të qytetarit. Për të mos shkuar më tej, edhe vetë morali i shoqërisë, në instancë të fundit, lidhet me qytetarinë.

Orientimi i institucioneve drejt politikave me qendër qytetarin dhe fuqizimi i qytetarëve përmes strukturave komunitare për pjesëmarrje dhe angazhim civil janë dy anë që garantojnë mirëqeverisjen.

Prandaj, IDM ka bindjen se Bashkia dhe Këshilli Bashkiak i Tiranës së bashku me shoqërinë civile dhe grupe të tjera vullnetarësh do të punojnë tok për një model funksionues të strukturave komunitare duke rrezatuar në të gjithë vendin.

Informacioni në këtë manual synon të jetësojë në gërmë dhe në frymë “Ligjin e ri Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (nenet 68 & 69). Kjo qasje buron nga nevojat e brendshme për forcimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe mbështetet nga një studim krahasues i vendeve të rajonit dhe më gjerë.





Strukturat komunitare në ligjin e ri “Për Vetë Qeverisjen Vendore”

Ligji i ri Nr. 135/2015, “Për Vetë Qeverisjen Vendore”, i miratuar në dhjetor 2015 dhe që hyri në fuqi në 30 janar 2016, i kushton dy nene të veçanta strukturave komunitare, përfshirë këtu ndërlidhësin komunitar dhe këshillin.

Neni 68


Struktura komunitare në qytet

1. Në qytete, në bazë të iniciativës qytetare, ngrihen dhe funksionojnë këshillat komunitarë të lagjeve. Këshillat përbëhen nga banorë të lagjes dhe organizohen mbi baza vullnetare.
2. Këshillat bashkiakë përcaktojnë rregullat e përgjithshme të organizimit e të funksionimit të këshillave komunitarë të lagjeve dhe marrëdhëniet që ato kanë me bashkinë dhe strukturat e saj.
3. Nga radhët e anëtarëve të këshillave komunitarë zgjidhen ndërlidhësit komunitarë që drejtojnë dhe organizojnë punën e këshillave.
4. Si rregull, në çdo lagje krijohet një këshill komunitar. Këshilli bashkiak mund të vendosë që në një lagje të krijohen më shumë se dy këshilla komunitarë ose bashkimin e këshillave të dy apo më shumë lagjeve.

Neni 69

Detyrat dhe të drejtat e këshillit dhe ndërlidhësit komunitar

1. Ndërlidhësi dhe këshilli komunitar mund të mbështesin funksionet qeverisëse të bashkisë në lagjen e tyre dhe mund të zbatojnë projekte në dobi dhe përfitim të komunitetit.
2. Këshillat komunitarë, në bazë të vendimeve të këshillave bashkiakë, kanë të drejtë të kryejnë funksione dhe kompetenca të caktuara që mund t'u delegohen nga këshilli. Në këtë rast, këshilli bashkiak vendos edhe për masën e financimit apo bashkëfinancimit për kryerjen e funksionit apo kompetencës së deleguar, të cilat nuk mund të përdoren në asnjë rast për shpërblime apo pagesa për anëtarët e këshillit komunitar.
3. Ndërlidhësi komunitar mund të shpërblehet për punën që kryen, sipas kriterëve të përcaktuara nga këshilli bashkiak, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Detyrat më të hollësishme të tyre përcaktohen në rregulloret dhe urdhëresat e këshillit bashkiak.



Misioni i strukturave komunitare është jetësimi i demokracisë pjesëmarrëse përmes fuqizimit, organizimit dhe mobilizimit të qytetarëve për çështje që kanë rëndësi themelore për ta.

Në thelb të të gjitha nismave dhe përpjekjeve të strukturave komunitare qëndron vullnetarizmi. Qytetarët bëhen bashkë, pasi besojnë se mund të ndryshojnë komunitetin ku jetojnë; interesat e përbashkëta triumfojnë mbi ato personale. Qytetarët janë të ndërgjegjshëm se ndryshimi mund të vijë nga vetë ata duke bashkuar forcat dhe duke vepruar në mënyrë strategjike për të zgjidhur problemet që i shqetësojnë.

Dinamikat që shoqërojnë këtë lloj zhvillimi, kaq të munguar në komunitetet shqiptare, çojnë në forcimin e kohezionit social dhe rritjen e kërkesës së llogarisë ndaj zyrtarëve. Komunitetet transformohen gradualisht në hapësira ku qytetarët janë të mirë-organizuar dhe zyrtarët të përgjegjshëm. Në këtë mënyrë, komunitetet lulëzojnë.

Kjo dinamikë nxit modele të aktivizimit qytetar, organizimit në grupe sipas interesave, marrjes së përgjegjësisë komunitare për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës në çdo lagje e fqinjësi urbane.

Misioni lidh qytetarin me mjedisin social dhe komunitetin vendor duke nxitur përgjegjshmërinë për jetë më të mirë dhe më të sigurt. *Bashkëpunimi dhe ndërveprimi qytetar* marrin një dimension të ri. Vullnetarizmi mbetet vlera që shoqëron këto procese.

1

Ndërlidhësi dhe anëtarët e këshillit komunitar bashkëpunojnë me individë, familje dhe grupe

me qëllim fuqizimin e tyre dhe nxitjen e ndryshimit social. Ndërlidhësi dhe anëtarët e këshillit komunitar punojnë për identifikimin e burimeve, nevojave, dhe mundësive që ekzistojnë në komunitet; ndërgjegjësimin e banorëve rreth të drejtave dhe përgjegjësisë; planifikimin e hapave që duhet të ndërmerren me qëllim adresimin e problemeve që përballet komuniteti; dhe zhvillimin e aktiviteteve, të cilat forcojnë kohezionin social dhe mekanizmat e llogaridhënies, nxisin pjesëmarrjen në vendimmarrje në nivel vendor, dhe ngjallin besim në ndryshimin që vjen nga vetë komuniteti.

2

Strukturat komunitare fokusohen në problemet e ditës,

të cilat shqetësojnë komunitetin, si mjedisi, papunësia, pabarazia, mungesa e shërbimeve publike ose cilësia e dobët e tyre. Për të trajtuar problemet, ndërlidhësi dhe anëtarët e këshillit komunitar veprojnë në mënyrë strategjike duke krijuar dhe mobilizuar lidhje horizontale¹ dhe vertikale,² duke investuar kohë dhe energji në formimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me autoritetet vendore dhe aktorë të ndryshëm vendorë si organizatat e shoqërisë civile, bizneset, si dhe duke diskutuar ide, duke kërkuar mbështetje dhe burime që mund të çojnë në zgjidhjen e problemeve.

3

Ndërlidhësi dhe anëtarët e këshillit komunitar punojnë në grup.

Struktura e fortë komunitare përbëhet nga individë që kanë interesa të përbashkëta si dhe vënë interesat e komunitetit mbi ato personale. Ndërlidhësi dhe anëtarët e këshillit komunitar ndajnë të njëjtin vizion dhe qëllim, kanë role të përcaktuara që mbështeten në talentet e tyre, kanë aftësi të ndryshme që plotësojnë njëra-tjetrën si dhe besojnë e respektojnë njëri-tjetrin.

4

Ndërlidhësi dhe anëtarët e këshillit komunitar reflektojnë në mënyrë të vazhdueshme rreth punës

së tyre dhe punojnë për të forcuar marrëdhënien brenda grupit. Strukturat komunitare kanë një

1 Lidhje që vendosen brenda strukturave komunitare apo ndërmjet strukturave komunitare.

2 Lidhje që vendosen midis strukturave komunitare dhe bashkisë ose institucioneve të tjera publike.

kulturë organizative bashkëpunuese dhe fokusohen në zgjidhjen e problemeve.

5

Ndërlidhësi dhe anëtarët e këshillit komunitar mbështesin nismat që përqendrohen në matjen e ndikimit të politikave dhe programeve apo mbledhjen e informacionit rreth shqetësimeve të banorëve rregullisht. Ata e përdorin këtë informacion me qëllim advokimin për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet.

6

Ndërlidhësi dhe anëtarët e këshillit komunitar punojnë për organizimin e fushatave informuese me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të popullsisë rreth ndryshimeve ligjore apo politikave dhe programeve që ndikojnë mirëqenien e tyre. Njëkohësisht, përdorin teknika të ndryshme për shpërndarjen e informacionit, të cilat prekin të gjitha grupet e popullsisë, në të gjitha zonat, qofshin ato qendrore apo periferike.

7

Ndërlidhësi dhe anëtarët e këshillit komunitar punojnë për të forcuar kapacitetet e tyre si individë dhe grup. Për shembull, ata mësojnë si të përmirësojnë marrëdhëniet me banorët, si të komunikojnë në mënyrë efektive, si të bisedojnë dhe negociojnë, si të zgjerojnë rrjetin e njohjeve brenda dhe jashtë komunitetit.

8

Strukturat komunitare punojnë për forcimin e mekanizmave të llogaridhënies ku banorët kanë më shumë mundësi të ndërveprojnë me autoritetet vendore dhe t'i vendosin ato para përgjegjësisë. Ndërlidhësi dhe anëtarët e këshillit komunitar nxisin angazhimin e zyrtarëve gjatë takimeve në komunitet. Në këtë mënyrë, banorët marrin informacion rreth projekteve dhe nismave që do të zbatohen. Njëkohësisht, banorët kanë mundësi të vendosin zyrtarët para përgjegjësisë dhe të kërkojnë përmirësimin e shërbimeve.

9

Ndërlidhësi dhe anëtarët e këshillit komunitar punojnë për identifikimin e metodave të përshtatshme të organizimit, të cilat marrin parasysh karakteristikat vendore. Për shembull, ata shmangin organizimin e takimeve në mjedise formale ku banorët mund të mos ndihen të lirë të shprehin mendimin e tyre, apo diskutojnë dhe identifikojnë metoda, aplikimi i të cilave, gradualisht, mund të çojë

në forcimin e besimit të banorëve. Ndërlidhësi dhe anëtarët e këshillit komunitar organizojnë takime në mënyrë të vazhdueshme.

10

Ndërlidhësi dhe anëtarët e këshillit komunitar vendosin marrëdhënie të forta bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile apo aktorë të tjerë lokalë dhe mbështeten tek njëri-tjetri në mënyrë reciproke.

11

Strukturat komunitare kanë një plan pune, i cili hartohet në bashkëpunim dhe reflekton përpjekjet për fuqizimin e komunitetit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet. Ndërlidhësi komunitar dhe anëtarët e këshillit punojnë si grup i bashkuar dhe jo si individë me qëllime dhe interesa të ndryshme. Ata ndjekin takimet në mënyrë të rregullt, ndajnë përgjegjësitë, dhe respektojnë mendimet e njëri-tjetrit.

12

Ndërlidhësi dhe anëtarët e këshillit komunitar kanë aftësi shumë të mira komunikuese, organizative, ndërpersonale, bashkëpunuese, njohje shumë të mirë të problemeve sociale dhe ekonomike që karakterizojnë komunitetin, njohuri të mënyrës si funksionon sektori publik dhe jo publik, janë pozitivë, të hapur, dhe nuk kanë qëndrime paragjyquese.

13

Ndërlidhësi dhe anëtarët e këshillit komunitar i kushtojnë rëndësi procesit të komunikimit me banorët. Ata japin mesazhe inkurajuese; i nxisin banorët të reflektojnë rreth rolit që mund të luajnë në iniciativat lokale në bashkëpunim me njëri-tjetrin; inkurajojnë besim në vetvete dhe tek të tjerët.

14

Përbërja e strukturës komunitare reflekton përbërjen e komunitetit, në lidhje me moshën, gjininë, etninë apo karakteristika të tjera. Gjatë takimeve, ndërlidhësi dhe anëtarët e këshillit komunitar inkurajojnë përfshirjen e grupeve të ndryshme në diskutim, duke i kushtuar rëndësi të veçantë grupeve të përjashtuara. Si rezultat i diskutimit, përvojës dhe ekspertizës që sjellin grupe të ndryshme, njerëzit mësojnë më shumë rreth njëri-tjetrit dhe punojnë së bashku. Ndërlidhësi dhe anëtarët e këshillit komunitar sfidojnë besimet dhe qëndrimet diskriminuese, duke dhënë kështu një shembull të mirë në komunitet.



1

Ndërlidhësi dhe këshilli komunitar vendosin raporte në ndihmë dhe mbështetje të veprimtarisë së bashkisë dhe institucioneve të tjera publike.

2

Ndërlidhësi merr detyra nga Këshilli dhe Kryetari i Bashkisë, detyra që lidhen me misionin e strukturave komunitare. Me vendim të Këshillit Bashkiak realizohet i gjithë procesi rregullator i formimit dhe veprimtarisë së këshillit komunitar dhe ndërlidhësit.

3

Ndërlidhësi dhe këshilli komunitar mund të lehtësojnë kontaktet dhe mundësojnë bashkëpunimin me institucione të ndryshme në komunitet, si institucionet mjedisore, shkollat, veçanërisht në kuadër të nismës së “shkollës si qendër komunitare”, me emergjencat civile, etj.

4

Ndërlidhësi dhe këshilli komunitar bashkëpunojnë dhe bëjnë të mundur një mjedis të mirë për policimin në komunitet duke kontribuar kështu në sigurinë publike.

5

Ndërlidhësi dhe këshilli komunitar ndihmojnë në zhvillimin vendor duke mobilizuar kontribute të ndryshme të qytetarëve dhe sektorit privat. Fushëveprimi lidhet me politikat e BE-së në lidhje me zhvillimin e udhëhequr nga komuniteti.

5

DIMENSIONET
E FUQIZIMIT TË
KOMUNITETIT

1. Besimi: të përmirësosh aftësitë e njerëzve, njohuritë dhe besimin, dhe të rrënjosësh mendimin se vetë ata mund të bëhen agjentë ndryshimi.

2. Përfshirja: të veprosh i vetëdijshëm se diskriminimi është i pranishëm, të nxitësh barazinë e mundësive dhe marrëdhënieve të mira ndërmjet grupeve dhe të sfidosh pabarazinë dhe përjashtimin.

3. Organizimi: të sjellësh së bashku njerëzit në mënyrë që të diskutojnë rreth çështjeve dhe shqetësimeve të përbashkëta në grupe që janë të hapura dhe që karakterizohen nga vendimmarrje demokratike.

4. Bashkëpunimi: të ndërtosh marrëdhënie pozitive ndërmjet grupeve, të identifikosh interesat e përbashkëta, të krijosh dhe mbash lidhje me aktorë të ndryshëm, si dhe të përkrahësh krijimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit.

5. Ndikimi: të inkurajosh pjesëmarrjen e komunitetit në proceset vendimmarrëse dhe të ndikosh në proceset politikëbërëse.



**A mund të
jesh anëtar
i këshillit
komunitar?**



PO, NËSE JE BANOR!

PO, NËSE DËSHIRON TË KONTRIBUOSH!

PO, NËSE MENDON SE KOMUNITETI DHE FQINJËSIA
MERITOJNË MË SHUMË!

PO, NËSE SHIKON DREJT NJË TË ARDHMEJE MË TË
MIRË!

Ti mund të jesh i ri apo i moshuar, i punësuar apo i papunë,
pavarësisht statusit social.

PO, NËSE BESON TEK NDRYSHIMI!

PO, NËSE BESON TEK PËRPJEKJA E PËRBASHKËT!

PO, NËSE NUK PRET QË GJITHÇKA TA BËJNË TË TJERËT
PËR TY!

Ligji kërkon që strukturat komunitare të burojnë nga nisma
qytetare dhe janë në thelb vullnetare.

1

FORCIMI I BESIMIT TË QYTETARËVE TEK NJËRI-TJETRI.

Individët, të cilët kanë besim tek njëri-tjetri, kanë më shumë gjasa të bashkëpunojnë dhe të marrin pjesë në nisma kolektive (Uslaner, 2003). Besimi nxit optimizmin, tolerancën dhe solidaritetin (Putnam, 2000). Studimet tregojnë se nivelet e besimit në Shqipëri janë të ulëta. Rezultatet e Hulumtimit Social Evropian (2013) nxjerrin në pah se Shqipëria ka ndër nivelet më të ulëta të besimit social³ në Evropë. Ndërlidhësi dhe anëtarët e kështillit komunitar duhet të organizojnë aktivitete, të cilat krijojnë mundësi që banorët të vijnë së bashku, të njohin njëri-tjetrin dhe të diskutojnë probleme të përbashkëta. Aktivitetet mund të çojnë në rritjen e ndërgjegjësisë rreth problemeve me të cilat përballen banorët dhe mobilizimin e burimeve të përbashkëta për të përmirësuar cilësinë e jetës në komunitet.

2

MOBILIZIMI I KOMUNITETIT NË PRANI TË VARFËRISË DHE PËRJASHTIMIT SOCIAL.

Varfëria përbën një nga pengesat kryesore për angazhimin e qytetarëve në veprimtaritë vendore. Nëse individët luftojnë për të përmbushur nevojat bazë, atëherë ata mund të kenë më pak kohë dhe energji për t'u angazhuar me organizatat vendore (Mandel, 2002). Pasiguria për të ardhmen çon në skepticizëm ndaj nismave kolektive (Cook et al., 2004). Varfëria është e lidhur ngushtësisht me përjashtimin social. Individët që jetojnë në varfëri kanë më pak gjasa të marrin pjesë në jetën sociale, ekonomike dhe politike. Strukturat komunitare duhet t'i kushtojnë vëmendje grupeve të varfra dhe të përjashtuara. Nëse takimet e zhvilluara në komunitet tërheqin vetëm një grup homogjen,

3 Matja e besimit social mbështetet në pohimet e mëposhtme: (a) duhet të jesh shumë i kujdesshëm në marrëdhëniet me njerëzit apo shumicës së njerëzve mund t'u besohet; (b) shumica e njerëzve do të përpiqeshin të përfitonin prej meje apo shumica e njerëzve do të përpiqeshin të ishin të drejtë; (c) njerëzit në të shumtën e rasteve kujdesen për veten e tyre apo në të shumtën e rasteve njerëzit mundohen të ndihmojnë (Hulumtimi Social Evropian, 2013).

për shembull, individët të cilët kanë lidhje të afërta me zyrtarët, atëherë strukturat komunitare do të çojnë në thellimin e hendekut social dhe ekonomik. Kapërcimi i kësaj sfide do të kërkojë ndërmarrjen e një sërë hapash. Për shembull, takimet mund të bëhen jo vetëm në qendër të komunitetit por edhe në zonat periferike. Përbërja e këshillit komunitar të reflektojë përbërjen e komunitetit dhe informacioni rreth takimeve të shpërndahet në të gjitha lagjet e zonat duke përdorur forma të ndryshme të përhapjes së informacionit.

3

MOBILIZIMI I KOMUNITETIT NË PRANI TË PABARAZISË SOCIALE DHE EKONOMIKE.

Shqipëria karakterizohet nga nivele të larta pabarazie (Instat, 2013). Pabarazia thellon ndarjen sociale, gërryen besimin dhe kohezionin social, ndikon negativisht pjesëmarrjen në organizatat lokale, dobëson gjasat për të votuar, protestuar, dhe lobuar për ndryshim (Neckerman & Torche, 2007). Aty ku ka më shumë pabarazi, ka edhe më shumë pesimizëm rreth rritjes ekonomike dhe përmirësimit të kushteve të jetesës. Pritshmëritë për të ardhmen janë të ulëta. Njëkohësisht, aty ku ka më shumë pabarazi, ka edhe më shumë mosbesim tek të tjerët (Center for American Progress, 2012). Pakënaqësia me zhvillimet politike dhe ekonomike është e lidhur ngushtësisht me mungesën e besimit tek zyrtarët. Një nga sfidat e strukturave komunitare është të mobilizojë komunitetin pavarësisht pabarazisë sociale dhe ekonomike; të zgjojë interesin e grupeve që ndihen të përjashtuara nga proceset e zhvillimit social dhe ekonomik për të marrë pjesë në organizimet lokale. Kjo sfidë bëhet akoma edhe më e madhe me reformën territoriale dhe administrative, e cila ka rritur distancën fizike midis banorëve dhe përfaqësuesve vendorë. Qytetarët shprehen të shqetësuar se kjo reformë do të thellojë hendekun midis zonave urbane dhe rurale (Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe Instituti Demokratik Amerikan, 2016). Ata kërkojnë më shumë mundësi për ndërveprim me përfaqësuesit në nivel vendor dhe qendror.



4

SHKËPUTJA NGA TRASHËGIMIA KOMUNISTE.

Një nga efektet e sistemit të centralizuar të vendimmarrjes të periudhës komuniste është stepja e nismës personale. Edhe pse kjo trashëgimi është venitur në kohë, ajo vazhdon ende të ndikojë. Ashtu si në të kaluarën, njerëzit shpesh besojnë se është përgjegjësia e zyrtarëve t'i mobilizojnë ata në nisma komunitare (Bartkowski, 2003; Buchowski, 1996). Njëkohësisht, aktivitetet vullnetare perceptohen si trashëgimi e periudhës komuniste dhe për disa realizimi i aktiviteteve vullnetare është një rikthim i padëshiruar në të kaluarën. Sfida e strukturave komunitare është të kapërcejë këto besime dhe perceptime, duke theksuar rolin që mund të kenë vetë banorët në nismat vendore. Kjo kërkon një sërë përpjekjesh që fokusohen në fuqizimin e qytetarit. Megjithatë, trashëgimia komuniste nuk kufizohet vetëm në aspekte negative. Një nga ndikimet pozitive lidhet me përvojën që individët kanë fituar në organizatat profesionale. Edhe pse këto organizata u përdorën për të avancuar qëllime partiake, ato nxitën solidaritet dhe përkushtim ndaj interesave kolektive (Howard, 2003). Individët, veçanërisht ata që kanë jetuar rininë e tyre gjatë periudhës komuniste, flasin me pasion për punën kolektive dhe bashkëpunimin me të tjerët. Në këtë kontekst, strukturat komunitare mund të mbështeten në përvojën ekzistuese dhe njëkohësisht të sfidojnë besimet e trashëguara nga e kaluara.

5

DHËNIA FUND E PRAKTIKAVE KLIENTELISTE.

Praktikat klienteliste në shpërndarjen e të mirave dhe shërbimeve dëmtojnë solidaritetin mes banorëve dhe pjesëmarrjen e tyre në nisma kolektive. Në rastet kur banorët ndeshin vështirësi për marrjen e shërbimeve, ata nuk organizohen në grup për të kërkuar ndryshimin e situatës, por përdorin forma individuale, për shembull kontaktojnë zyrtarët apo të afërmit e tyre, të cilët shërbejnë si ndërlidhës me zyrtarët (Dauti, 2016). Strukturat komunitare duhet të distancohen nga praktikat klienteliste duke theksuar rëndësinë e organizimit dhe mobilizimit të banorëve dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për të gjithë. Për sa i përket angazhimit politik, një studim i realizuar së



fundmi tregon se qytetarët kanë më shumë gjasa të diskutojnë me njëri-tjetrin rreth politikës sesa të marrin pjesë në dëgjuesat publike apo takimet e këshillave vendore ku kanë mundësi të kontaktojnë drejtpërsëdrejti me zyrtarët dhe t'i vendosin ata para përgjegjësisë (Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe Instituti Demokratik Amerikan, 2016). Strukturat komunitare duhet të mbështesin banorët të shprehin shqetësimet përmes aksionit kolektiv dhe të nxisin pjesëmarrjen në hapësirat formale.

6

INKURAJIMI I PJESËMARRJES NË ORGANIZATAT VENDORE.

Studime të ndryshme kanë nxjerrë në pah nivele të ulëta të pjesëmarrjes në organizatat lokale (p.sh. IDM, 2010). Një nga sfidat e strukturave komunitare është mobilizimi i banorëve në veprimtaritë në nivel vendor. Një nga arsytet pse banorët mund të hezitojnë të marrin pjesë në strukturat komunitare apo në aktivitetet e organizuara nga strukturat komunitare është se ata mund të mendojnë se këto struktura shërbejnë për të interesa politike dhe ekonomike të elitës apo të një grupi të caktuar. Të dhënat tregojnë se nismat vendore që synojnë rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje kanë një sërë problemesh, si për shembull, individët që përfshihen në proceset pjesëmarrëse kanë lidhje personale dhe politike me zyrtarët (Gaventa & Barrett, 2012). Strukturat komunitare duhet të punojnë fort për të dhënë mesazhin se ato janë struktura të cilat përfaqësojnë interesat e komunitetit dhe jo interesat e elitës.

7

ZBUTJA E POLARIZIMIT POLITIK.

Një tjetër sfidë e strukturave komunitare është mobilizimi i banorëve në prani të polarizimit politik dhe konflikteve politike. Takimet apo aktivitetet mund të tërheqin vetëm militantët partiakë apo mbështetësit e forcës politike në pushtet. Ky grup është më shumë i prirur të shprehë besim tek zyrtarët sesa t'i kritikojë ata. Për këtë arsye, strukturat komunitare duhet të jenë shumë të kujdesshme në përzgjedhjen e

anëtarëve. Ndërlidhësi komunitar duhet të jetë një person i dalluar me reputacion të mirë në komunitet si dhe të jetë i pavarur. Duhet të shmangët transformimi i strukturës komunitare në një mekanizëm që i shërben interesave politike dhe ekonomike të një grupi të vogël individësh.

8

MOBILIZIMI I KOMUNITETIT NË PRANI TË NIVELIT TË ULËT TË TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES.

Pavarësisht përmirësimit në kohë, Shqipëria renditet si një nga vendet me nivel të lartë të korrupsionit (Transparency International, 2014). Shqiptarët e rendisin korrupsionin si problemin e dytë më të madh, pas papunësisë (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimet dhe Instituti i Statistikave, 2011). Më shumë së gjysma e shqiptarëve besojnë se korrupsioni ndodh shpesh ose shumë shpesh në qeverinë qendrore ose vendore (po aty). Studimi i realizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (2015) tregon se “47% e qytetarëve të anketuar [n=1,600] besojnë se institucionet publike shqiptare nuk janë transparente dhe të përgjegjshme” (f. 5). Këto të dhëna sugjerojnë se duhet të punohet shumë për të rritur nivelin e transparencës dhe kërkesës së llogarisë. Perceptimi i korrupsionit ka një efekt të drejtpërdrejtë në angazhimin e banorëve në vendimmarrjen vendore. Banorët mund të shprehin pak interes në organizimet vendore, pasi mendojnë se opinionet e tyre nuk do të merren parasysh. Banorët do të ndihen të përjashtuar nga vendimmarrja vendore dhe nuk do të marrin pjesë në organizatat që mbështeten prej tyre. Sfida e strukturave komunitare është të nxisë interesin tek organizimet vendore pavarësisht zhgënjimit nga elita politike dhe të mungesës së transparencës dhe përgjegjësisë së institucioneve publike.



**9**

KRIJIMI I NJË FORUMI TË HAPUR KU BANORËT NDIHEN TË LIRË TË SHPREHIN MENDIMET E TYRE.

Pjesëmarrja në takimet e organizuara në komunitet nuk do të garantojë që banorët do të vendosin zyrtarët para përgjegjësisë. Banorët mund të marrin pjesë për të marrë informacione por jo për t'i kërkuar llogari zyrtarëve nga frika e pasojave që mund të ketë kritika e tyre tek ata vetë apo tek të afërmit e tyre. Sfida është krijimi i një forumi ku banorët nuk ndihen të kërcënuar se informacioni që do të japin, veçanërisht kritikën ndaj zyrtarëve, të ketë pasojë negative. Duke vepruar si ndërlidhëse të banorëve me pushtetin vendor, strukturat komunitare mund të rrisin mundësitë për komunikim të vazhdueshëm midis banorëve dhe zyrtarëve, dhe krijimin e një hapësire ku banorët mund të komunikojnë shqetësimet e tyre si dhe të diskutojnë alternativa për ndryshimin e situatës.

10

PËRMIRËSIMI I QASJES NË INFORMACION.

Aktualisht, qasja në informacion në Shqipëri karakterizohet nga një sërë problemesh. Shpesh, informacioni nuk arrin pjesën dërrmuese të popullsisë. Informacioni nuk komunikohet në një gjuhë të thjeshtë në mënyrë që të kuptohet nga popullsia me nivel të ulët arsimimi. Njëkohësisht, nuk ofrohet mbështetje për grupet e përjashtuara, si personat me aftësi të kufizuara (UNDP, 2014). Në mungesë të informacionit, banorët nuk mund të ngrenë zërin për të kërkuar të drejtat e tyre apo për t'i vënë zyrtarët para përgjegjësisë. Strukturat komunitare duhet të punojnë shumë për të përmirësuar qasjen në informacion, në mënyrë që çdo banor të ketë njohuritë bazë të ligjit.

11

VENDOSJA E MARRËDHËNIEVE TË FORTA TË BASHKËPUNIMIT ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE.

Suksesi i strukturave komunitare varet nga niveli në të cilin ato do të vendosin marrëdhënie të forta bashkëpunimi me organizatat

e shoqërisë civile. Ndërkohë që shqiptarët janë skeptikë rreth organizatave të shoqërisë civile (IDM, 2010), vihet re se qëndrimi i tyre në kohë është përmirësuar. Studimi i realizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe Instituti Demokratik Amerikan (2016) tregon se qytetarët janë të interesuar të marrin pjesë në aktivitetet e organizuara nga shoqëria civile, të cilat do të çojnë në ndryshimin e situatës me të cilën ata përballen. Një tjetër sfidë, përveç vendosjes së marrëdhënieve të bashkëpunimit, lidhet me numrin e kufizuar të organizatave të shoqërisë civile në qytetet e largëta. Afërsisht, 90% e organizatave të shoqërisë civile janë të përqendruara në Tiranë dhe qytetet kryesore të vendit (IDM, 2012).



SHEMBUJ
TË
ANGAZHIMIT
QYTETAR
NË ZHVILLIMIN
VENDOR

“ **Grupet me bazë komunitare në Shkodër**

Dhjetë vite më parë, tre grupe me bazë komunitare, konkretisht grupi i lagjes “Luigj Gurakuqi,” grupi i lagjes “Bajram Curri,” dhe grupi i lagjes “Filip Shiroka” në Shkodër, krijuan një përvojë të veçantë pune duke modeluar për herë të parë struktura komunitare përfaqësuese të banorëve të lagjes. Aktivizimi i qytetarëve ishte tërësisht vullnetar por dhe i inkurajuar nga një mjedis mundësues i Bashkisë Shkodër. Modeli përbënte një risi dhe në shumë raste, ku biznesi vendor mbështeste nismat e grupimit me bazë komunitare. Bashkia ndërveproi me grupet komunitare për investimet infrastrukturore që përfshinin si punën vullnetare të banorëve ashtu edhe monitorimin e cilësisë së investimeve të bashkisë në lagjet përkatëse. Në përfundim të punës, krenaria e qytetarëve ishte legjitime: plakarda “I lumtë komunitetit ‘Filip Shiroka’” lidhte shtyllat në të dyja anët e rrugës.

Burimi: IDM & Balkan Trust for Democracy (2006)



“ Mobilizimi komunitar dhe infrastruktura vendore

Fondi Shqiptar i Zhvillimit gjatë viteve 2003-2006, për çdo projekt të infrastrukturës vendore publike kërkonte të krijohej një grup vendor që quhej Grupi i Këshillimit dhe Monitorimit. Anëtarët e këtij grupi zgjidheshin nga banorët në zonën ku realizohej projekti në mbledhje të hapura publike. Grupet kishin një rol të rëndësishëm në fazën përgatitore, të projektimit, prokurimit dhe monitorimit të punimeve. Kontributi i tyre ka qenë i rëndësishëm në informimin e qytetarëve, konsultimin me projektuesin, negocimin për zgjidhje të çështjeve të pronësisë, por sidomos në monitorimin e zbatimit të punimeve. Këto grupe kishin rol edhe në pranimin përfundimtar të objekteve infrastrukturore si dhe në mirëmbajtjen e vazhdueshme të tyre nëpërmjet mobilizimit komunitar. Falë tyre, objektet infrastrukturore si shkolla, qendra shëndetësore, tregje, dhe rrugë nuk shikoheshin si dhuratë nga ‘jashtë’, por si objekte të kontributit të gjithë komunitetit.

Burimi: E. Azizaj, Inspektore Sociale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit (2003-2006)

“ Organizatat me bazë komunitare në Kukës

Me mbështetjen e qeverisë vendore dhe PNUD-it, gjatë periudhës shkurt 2005-tetor 2007, u krijuan 145 organizata me bazë komunitare me rreth 4200 anëtarë, të cilët u përfshinë në zhvillimin vendor: (i) duke përzgjedhur projekte të vogla infrastrukturore në komunitetin e tyre në fushën e arsimit, kujdesit shëndetësor, mjedisit, gjelbërimit, etj.; (ii) duke kontribuar në zbatimin e projekteve si dhe duke ofruar dhe dhuruar materiale të ndryshme, makineri deri edhe tokë; (iii) duke mbikëqyrur punimet; dhe (iv) duke ndërtuar mekanizma vullnetarë të mirëmbajtjes së objekteve pas përfundimit.

Në një anketë të realizuar me 454 individë – banorë, anëtarë të organizatave komunitare, dhe zyrtarë – rreth 93% raportuan se këto organizata janë mjaft efikase për trajtimin e problemeve të zhvillimit me të cilat përballet komuniteti i tyre. Afro 92% e të anketuarve thanë se do të kontribuonin në qëndrueshmërinë e projekteve të infrastrukturës të marrë në dorëzim përmes mirëmbajtjes apo shërbimeve të tjera, ose nëpërmjet pagesës së tarifave. Brenda një periudhe të shkurtër, kënaqshmëria e banoreve me shërbimet e bashkisë u rrit me 35%. Ja disa nga përvojat e banorëve:

Ndryshimi që sjell pjesëmarrja në organizatat me bazë komunitare: përvoja e banorëve të Kukësit

“Duke punuar së bashku, mësova se qeveria vendore nuk është aq e keqe si pata menduar më parë.” (banor i komunës Bushtricë, f. 17)

“Duhet të planifikojmë së bashku në qoftë se duam të zgjidhim problemet tona, në vend që të ankohe mi tek njëri-tjetri dhe

të presim pa fund, siç bënim në të kaluarën.” (banor i fshatit Bushtricë, f. 12)

“Kemi mësuar se në këtë mënyrë mund të zgjidhim problemet tona dhe të trajtojmë nevojat tona.” (përfaqësues i organizatës komunitare, Bushtricë, f. 4)

“Pjesa më e madhe e problemeve që kemi aktualisht mund të zgjidhet brenda fshatit, nëse luajmë një rol aktiv dhe ofrojmë vullnetin tonë të mirë.” (banor i komunës Zapod, f. 9)

“Pjesëmarrja jonë dhe bashkëpunimi me njëri-tjetrin janë burimet tona kryesore. Madje më parë nuk e dinim se i kishim ato.” (banor i fshatit Petkaj, Shëmri. f. 7)

“Kemi kuptuar se qeveria nuk është në gjendje të bëjë gjithçka dhe asgjë nuk realizohet nëse nuk punojmë së bashku.” (banor i komunës Topojan, f. 11)

Burimi: UNDP (2005)



Fjalorth

aksion komunitar: përpjekjet e realizuara me qëllim sigurimin e burimeve, nxitjen e pjesëmarrjes politike apo rrëzimin e propozimeve, të cilat mund të bien ndesh me interesat e banorëve (Thomas & Pierson, 2010, p. 115).

asamble komunitare: strukturë lokale, e cila përbëhet nga ndërlidhësat komunitarë.

bord komunitar: strukturë lokale, e cila përbëhet nga ndërlidhësat komunitarë të një njësie bashkiake.

forum lagjeje: një organizatë gjysmë-formale, e cila sjell së bashku përfaqësuesit e organizatave lokale, përdoruesit e shërbimeve dhe banorët të shprehin mendimet e tyre rreth shërbimeve dhe projekteve që kanë qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet (Thomas & Pierson, 2010, f. 358).

fuqizim: çdo proces përmes të cilit ata që, krahasimisht, nuk kanë pushtet fitojnë ose ndihmohen të fitojnë më shumë pushtet (Thomas & Pierson, 2010, f. 205).

kapital social: lidhjet mes individëve – rrjetet sociale dhe normat e reciprocitetit dhe besueshmëria që lindin prej lidhjeve (Putnam, 2000, f. 19).

këshill komunitar: strukturë lokale, e cila ngrihet në bazë të iniciativës qytetare dhe përbëhet nga banorë të lagjes (neni 68, ligjit 139/2015).

klientelizëm: ofrimi i shërbimeve ekskluzive në shkëmbim të mbështetjes politike (Jamal, 2007, f. 14.).



kohezion social: *gadishmëria e anëtarëve të një shoqërie të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, të ndajnë një vizion të përbashkët dhe ndjenjë përkatësie. Në një komunitet me kohezion të lartë social, banorët kanë marrëdhënie të mira me njëri-tjetrin, banorët ndjejnë se i përkasin komunitetit, niveli i bashkëpunimit për projekte publike është i lartë, niveli i krimit është i ulët, dhe diferencat në bazë moshe, gjinie, origjine, etnie, apo karakteristika të tjera nuk shërbejnë për të ndarë banorët nga njëri-tjetri (Ratcliffe & Newman, 2011).*

komision për strukturat komunitare: *strukturë që ngrihet me vendim të këshillit të bashkisë për lehtësimin dhe monitorimin e procesit parazgjedhor dhe atë zgjedhor të strukturave komunitare.*

kuvend qytetar: *mbledhja e qytetarëve për të diskutuar çështje të ndryshme në territorin e një strukture komunitare.*

letër e angazhimit civil: *dokumenti i paraqitur nga kandidati për anëtar të këshillit komunitar nëpërmjet të cilit kandidati shpreh angazhimin dhe idetë e tij për organizimin komunitar.*

llogaridhënie: *parimi dhe procesi që garanton se zyrtarët e sektorit publik dhe përfaqësuesit e zgjedhur janë përgjegjës për veprimet e tyre (Thomas & Pierson, 2010, p. 6).*

llogaridhënie klienteliste: *zyrtarët e papërgjegjshëm janë më shumë të motivuar të përmbushin interesat personale sesa të ofrojnë shërbime publike prej të cilave përfiton gjithë popullsia (Keefer, Narayan, & Vishwanath, 2006).*

mobilizim komunitar: *procesi i ndërlidhjes së sektorëve të ndryshëm të komunitetit dhe krijimi i partneriteteve me qëllim trajtimin e çështjeve që shqetësojnë komunitetin. Mobilizimi komunitar përfshin aktivizimin e burimeve, shpërndarjen e informacionit, sigurimin e mbështetjes dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet sektorëve publik dhe privat në komunitet (Advocates for Youth, 2014).*

ndërlidhës komunitar: *personi i zgjedhur nga anëtarët e këshillit komunitar që drejton dhe organizon punën e këshillit.*

partneritet: një marrëdhënie pune që përfshin një numër organizatash, të cilat vendosin marrëveshje formale ose gjysmë-formale ku dakortësohen qëllimet, ndahen burimet, dhe planifikohet një strategji e përbashkët (Thomas & Pierson, 2010, f. 385).

përrjashtim social: procesi që privon individët dhe familjet, grupet dhe lagjet nga burimet që janë të domosdoshme për të lulëzuar në shoqëri (Thomas & Pierson, 2010, f. 485).

pjesëmarrje: procesi i përfshirjes së anëtarëve të komunitetit në vendimet që ndikojnë jetën e tyre dhe realizimin e ndryshimeve të dëshiruara (Thomas & Pierson, 2010, f. 384).

punë komunitare: një grup i gjerë praktikash të krijuara me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës për individët që jetojnë në një komunitet të caktuar (Thomas & Pierson, 2010, f. 113).

rrjetëzim: procesi, i cili lidh së bashku individë, grupe dhe/ose komunitete me interesa të përbashkëta me qëllim shpërndarjen e informacionit, njohurive, ndarjen e burimeve, dhe ofrimin e mbështetjes reciproke (Thomas & Pierson, 2010, f. 360).

rrjet social: rrjet i marrëdhënieve shoqërore përmes të cilave njerëzit lidhen me njëri-tjetrin. Rrjetet ekzistojnë në lidhje me individët dhe familjet si dhe lagje të tëra (Thomas & Pierson, 2010, f. 361).

strukturë komunitare: njetësimin e demokracisë pjesëmarrëse përmes fuqizimit, organizimit dhe mobilizimit të qytetarëve për çështje që kanë rëndësi themelore për ta.

vullnetarizëm: kontribut i papaguar, i realizuar jo në mënyrë të detyrueshme, dhe që çon në përfitime publike (UN Volunteers, 2011).



Burime informacioni

Advocates for Youth. (2014). Strategies Guided by Best Practice for Community Mobilization. Marrë nga <http://www.advocatesforyouth.org/publications/publications-a-z/2398-strategies-guided-by-best-practice-for-community-mobilization>

Bartkowski, J. (2003). 'Social Capital in Poland', in G. Badescu and E. M. Uslaner (eds.), Social Capital and the Transition to Democracy, pp. 184-199. New York: Routledge.

Buchowski, M. (1996). 'The Shifting Meanings of Civil and Civic Society in Poland', in C. M. Hann and E. C. Dunn (eds.), Civil Society: Challenging Western Models, pp. 79-98. New York: Routledge.

Center for American Progress. (2012). Income Inequality in the US Fuels Pessimism and Threatens Social Cohesion. Marrë më 28 Gusht, 2013 nga <http://www.americanprogress.org/wp-content/uploads/2012/12/Uslaner.pdf>.

Cook, K. S., Rice, E., & Gerbasi, A. (2004). 'The Emergence of Trust Networks Under Uncertainty: The Case of Transitional Economies', In J. Kornai, B. Rothstein, & S. Rose-Ackerman (eds.). Creating Social Trust in Post-Socialist Transition, pp. 193 – 212. New York: Palgrave Macmillan.

Dauti, M. (2016). Contesting Corruption: How the Poor Demand Accountability and Responsiveness from Government Officials. British Journal of Social Work. doi: 10.1093/bjsw/bcw019

Gaventa, J., & Barrett, G. (2012). *Mapping the Outcomes of Citizen Engagement*. *World Development* 40(12), 2399-2410.

Howard, M. M. (2003) 'Why Post-Communist Citizens do not Join Voluntary Organizations', in G. Badescu and E. M. Uslaner (eds.), *Social Capital and the Transition to Democracy*, pp. 165 – 183. New York: Routledge.

Hulumtimi Social Evropian. (2013). *Gjetjet Paraprake të Sondazhit Social Evropian*. Marrë nga <http://www.soros.al/2010/article.php?id=437>

Instat. (2013). *Shqipëria: Trendi i varfërisë, 2002-2005-2008-2012*. Tiranë: Instat.

Institute for Democracy and Mediation & Balkan Trust for Democracy. (2006). *Gazeta e Komunitetit*, No. 1.

Institute for Democracy and Mediation & Balkan Trust for Democracy. (2007). *Gazeta e Komunitetit*, No. 2.

Institute for Democracy and Mediation. (2010). *Civil Society Index for Albania: In Search of Citizens & Impact*. Tirana: IDM.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. (2012). *Shoqëria Civile në Zonat Rurale dhe Periferike të Shqipërisë: Nevojat, Sfidat dhe një Platformë Veprimi*. Tiranë: IDN.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. (2015). *Brief: Sondazhi i Opinionit Publik. Besimi në Qeveri*. Tiranë: IDN.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim & Instituti Demokratik Amerikan (2016). *Analizë e Angazhimit Politik në Shqipëri*. Tiranë: IDN & IDA.

Jamal, A. A. (2007). *Barriers to Democracy: The Other Side of Social Capital in Palestine and the Arab World*. Princeton: Princeton University Press.

Keefer, P. E, Narayan, A., & Vishwanath, T. (2006). 'Decentralization in Pakistan: Are Local Governments Likely to Be More Accountable Than Central Governments?' in *Decentralization and Local Governance in Developing Countries: A Comparative Perspective*, edited by P.



- Bardhan & D. Mookherjee (eds.), pp. 285-303. Cambridge: MIT Press.
- Mandel, R. (2002). 'Seeding Civil Society', in C. M. Hann (ed.), *Postsocialism: Ideals, Ideologies and Practices in Eurasia*, pp. 279-296. New York: Routledge.
- Neckerman, K. M., & Torche, F. (2007). *Inequality: Causes and Consequences*. *Annual Review of Sociology*, 33, 335-357.
- Pickett, K., & Wilkinson, R. (2009). *The Spirit Level*. Marrë nga <http://www.equalitytrust.org.uk/www.equalitytrust.org.uk/research/thespirtlevel>.
- Putnam, R., D. (2000). *Bowling Alone: The Collapse and Revival of American Community*. New York: Simon & Schuster.
- Ratcliffe, P., & , I. (Eds.). (2011). *Promoting Social Cohesion: Implications for Policy and Frameworks for Evaluation*. Bristol, UK: Policy Press.
- Thomas, M., & Pierson, J. (2010). *Dictionary of Social Work: The Definitive A to Z of Social Work and Social Care*. Berkshire, GBR: Open University Press.
- Transparency International. (2014). *Corruption Perceptions Index*. Marrë nga www.transparency.org/cpi2014/results
- United Nations Office on Drugs and Crime. (2011). *Corruption in Albania: Bribery as Experienced by the Population*. Vienna, United Nations Office on Drugs and Crime.
- United Nations Development Programme. (2014). *Social Housing in Albania: A Needs Assessment*. Marrë nga <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/needs-assessment-of-social-housing-in-albania//>
- United Nations Development Programme. (2005). *A Difference in the Making: An Independent Evaluation of the Kukes Regional Development Initiative Community Infrastructure Project*. Marrë nga



<https://erc.undp.org/evaluation/documents/download/585>

United Nations Volunteers. (2011). *Taking the Measure of Volunteering*. Marrë nga http://www.unv.org/fileadmin/docdb/pdf/2011/SWVR/English/SWVR2011_full_%5B04%5D_chapter1.pdf

Uslaner, E. M. (2003). 'Trust and Civic Engagement in East and West', in G. Badescu and E. M. Uslaner (eds.), *Social Capital and the Transition to Democracy*, pp. 81 – 94. New York: Routledge.

